



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-353/01-45039

Dt. 29.05.2024

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e posedim individual NTSH-Astra-B-SHPK Shfrytëzues Qirambajtje 99 vite – Nazmi M.Gashi B.I nga Prizreni në bazë të neneve 3alineja 1 pikat 1.1,1.4 ,1.11,1.16, 1.17,1.20,1.24 dhe të nenit 4 alineja 1 pika 1.2 ,e lidhur me nenin 5 alineja 1 pika 1.4 si dhe nenit 14.alineja 1 pika 1.5 si dhe ne lidhje me nenin 15 pika 1.1 dhe nenit 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, dhe në harmoni me dispozitat e nenit 3 alineja 1 pikat 1.1,1.3,1.5,1.6,1.7,dhe 1.8 e lidhur me nenet 4,5, dhe 9 dhe 11 të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit nr.04/L-066 ,si dhe Vendimit për miratimin e Planit Rregullues Urban për Konservim dhe Zhvillim të Zonës Historike të Prizrenit-Zona e Parë e Mbrojtjes nr.01/011—6604 të dt.18.12.2008 , nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të neneve 13,14,44,45,46,47,124 e në lidhje me nenin 125 LPA-së nr. 05/L-031, merr këtë:

VENDIM

I. LEJOHET: posedim individual NTSH-Astra-B-SHPK Shfrytëzues Qirambajtje 99 vite – Nazmi M.Gashi B.I nga Prizreni në zhvillimin e punimeve ndërtimin e kulmit të objektit-ndertesës me etazhitet P+0 në ngastrën kadastrale P-71813068-04870-4- ZK Prizren në” Sheshin Shatervan”.

II. Gjatë implementimit të projektit nuk lejohet kurrfarë zgjerimi në gabarit dhe lartësi .

III.Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin e ndërtimtarisë në afat prej 8 ditësh.

IV.Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Vendimi i QRTK nr. 140/2 te dt.20.05.2024 dhe Rekomandimi i KTKQH Prizren të dt. 16.05.2024.

V. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se me punë nuk fillohet brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke llogaritur nga dita e marrjes së të njëjtës.

VI. Pas kryerjes së punimeve shfrytëzuesi obligohet të pastroj vend punishten.



A r s y e t i m

Nga dokumentacioni teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara së bashku me kërkesë vërtetohet se:


Që me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional, të Komunës së Prizrenit.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve të KK Prizren, është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes në zhvillimin e punimeve në renovimin e objektit .

Nga se u tha më lartë u murr aktvendimi si në dispozitiv.

KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës , përmes këtij organi.

Bashkëpunëtor profesional


Zana Belloda, inxh.dip.ark

DREJTORI


Pranverim Berisha, jur.

